



MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

MBI

Bashkëpunimin dypalësh

midis


UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Tiranë, Republika e Shqipërisë

dhe

RRJETIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM RURAL (RRSHZHR)

Tiranë, Republika e Shqipërisë



ANRD
Nr 02/01-24
Datë më 16.01.2024

Për të forcuar dhe promovuar më tej bashkëpunimin dypalësh, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (RRSHZHR) firmosin këtë Marrëveshje Mirëkuptimi.

Kjo marrëveshje synon të vendosë një bashkëpunim dhe partneritet afatgjatë në fusha me interes të përbashkët të tilla si: edukimi dhe trajnimi profesional, kërkimi shkencor, dialogu për politikën e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm bujqësor e rural.

Të dyja palët do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për promovimin e aktiviteteve të mëposhtme bazuar në bashkëpunimin dhe përfitimin e ndërsjellë brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje:

1. Konsolidimi i bashkëpunimit në kuadër të platformës së parlamentit rural shqiptar dhe asamblesë së të rinjve nga zonat rurale dhe të tjera nisma advokuese për të influencuar politikëbërjen e sektorit bazuar në evidenca dhe pjesëmarrje me qasje nga poshtë-lart.

2. Koordinimin e përpjekjeve me synim gjenerimin e sinergjive për organizmin me sukses të nismave të përbashkëta me synimin final ndërtimin dhe avancimin e axhendës bujqësore dhe rurale shqiptare.
3. Bashkëpunimin në organizimin e konferencave, seminareve dhe aktiviteteve të tjera për tematika me interes të përbashkët.
4. Asistencë profesionale dhe bashkëpunim për aktivitetet e organizuara nga secili subjekt nëse kanë të bëjnë me aktivitete në fokus të palës tjetër.
5. Ofrimi i mundësive të studentëve të UBT-së për kryerjen e praktikave profesionale në RRSZHHR dhe/ose organizata anëtare të saj.
6. Informacion dhe orientime gjatë procesit të hartimit të temave të diplomës së Masterit ose Doktoraturës.
7. Mundësia për anëtarët e Qendrës së Rinisë Rurale (QRR) për t'u kualifikuar falë programeve të ofruara nga UBT në fushat e saj kryesore të edukimit.
8. Bashkëpunimi në realizimin e publikimeve dhe nismave pilot që lidhin fushat kryesore të studimit me çështjet e zhvillimit rural, gjinor dhe inovacionin në bujqësi, si me RRSZHHR, QRR dhe organizatat anëtare të RRSZHHR.
9. Leksione me qëllim edukimin në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm rural në Universitet nga RRSZHHR bazuar në përvojën praktike të saj, QRR dhe organizatave të RRSZHHR.
10. Leksione me qëllim edukimin në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm rural për RRSZHHR, QRR dhe organizatat anëtare të RRSZHHR në Universitet nga UBT bazuar në fushat kryesore të studimit dhe zhvillimet më të fundit të sektorit bujqësor jo vetëm në vend por edhe në nivelin ndërkombëtar.
11. Fusha të tjera të përcaktuara nga të dyja palët.

Periudha e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi është **pesë (5) vjet**. Ajo mund të rinovohet pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë, përveç nëse njëra palë jep një njoftim gjashtë-mujor për t'a përfunduar. Çështjet që nuk mbulohen nga Marrëveshja e Mirëkuptimit mund të negocohen veçmas nga të dy palët pa shfuqëzuar këtë Marrëveshje Mirëkuptimi.

Marrëveshja e Mirëkuptimit mund të ndryshohet me pëlqimin e të dyja palëve. Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e të dy institucioneve. Ajo është nënshkruar në dy kopje origjinale në shqip, ku secila palë mban një kopje origjinale të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar.

Nënshkruar më Tiranë _____ 2024

Prof. Dr. Fatbardh Sallaku
Rektori
Universiteti Bujqësor i Tiranës



Evelina Azizaj
Koordinatorë Kombëtare
Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural